



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Nr. 1419/Prot.
7

Tiranë, më 22 . 7 .2022

VENDIM

Nr. 12 , datë 20 . 07 .2022

“Për hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë të studimeve “Master Ekzekutiv” në “EU membership and accession negotiations”, në Institutin e Studimeve Evropiane, UT, për vitin akademik 2022-2023”

Bazuar në ligjin Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, pika 2, gërma b; neni 35, pika 1; neni 38, pika 1, gërma “dh”; neni 77, pika 2; në Udhëzimin e MASR-së nr. 1, datë 14.01.2020 “Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e IAL, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit, si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL”, Kreu IV, gërma “A”, i ndryshuar, Udhëzimin e MASR-së nr. 10, datë 30.03.2020 “Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”, Kreu I, pika 2, i ndryshuar, në Statutin e Universitetit të Tiranës neni 31, gërmat f), j) dhe cc); si dhe në propozimin e Institutit të Studimeve Evropiane me shkresën nr. 180 prot., datë 05.05.2022, Senati Akademik i Universitetit të Tiranës në mbledhjen e datës 20 . 07 .2022;

VENDOSI:

1. Të miratojë hapjen e programit të studimit të ciklit të tretë të studimeve “Master Ekzekutiv” në “EU membership and accession negotiations” me 60 kredite, të Institutit të Studimeve Evropiane, të UT-së sipas dokumentacionit bashkëngjitur, për vitin akademik 2022-2023.
2. Të miratojë formën e diplomës për programin e studimit të ciklit të tretë të studimit “Master Ekzekutiv” në “EU membership and accession negotiations”.
3. Dokumentacioni përkatës ngarkohet në platformën e-Albania për miratim të mëtejshëm nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.
4. Dokumentacioni përkatës përcillet në Qendrën e Shërbimeve Arsimore për regjistrimin e formës së diplomës.
5. Ky program studimi ofrohet në gjuhën angleze.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
PROF. DR. ARTAN HOXHA